MEDIActive
YOUTH
BALKANS

Dallimi midis Faktit dhe Trillimit

Mendimi Kritik

kundër

Çrregullimit të Informacionit dhe Propagandës

Kurrikulë

2025

Co-funded by
the European Union

Ky botim është realizuar si pjesë e projektit
MEDIActive Youth: Informimi i Ballkanit,
mbështetur nga *Programi Erasmus+*.
Autorët e botimit janë anëtarë të ekipit të ekspertëve
nga OJQ-të partnere, nën drejtimin e udhëheqësit të ekipit, Aleksandar Pavlović.
Konsorciumi i projektit përfshin gjashtë organizata nga Ballkani, të listuara më poshtë:

Centar za drustveno ekonomski razvoj
Serbia, **Koordinator**

Bosnian Representative Association for Valuable Opportunities
Bosnja dhe Hercegovina

Center for Intercultural Dialogue
Maqedonia e Veriut

Hrvatska edukacijska i razvojna mreza za evoluciju sporazumijevanja
Kroacia

Nevladino Udruzenje Prima
Mali i Zi

Pertej Barrierave
Shqiperia

Co-funded by
the European Union

Qëndrimet dhe opinionet e shprehura janë megjithatë vetëm të autorit/autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian apo të Agjencisë Ekzekutive për Arsim dhe Kulturë të Evropës (EACEA). As Bashkimi Evropian dhe as EACEA nuk mund të mbahen përgjegjës për to.

Përmbajtja

1. Hyrje në Njohuritë për Lajmet 4
2. Llojet e Medias: Tradicionalja vs Digjitalja, Masive & Sociale 6
3. Roli i Algoritmeve dhe Mediave Sociale 8
4. Epoka Post-së Vërtetës dhe Çrregullimi i Informacionit 10
5. Strategji Efektive të Kërkimit 12
6. Lajmet e Rreme, Dezinformimi dhe Keqinformimi 14
7. Verifikimi i Fakteve dhe Mjetet e Kontrollit të Informacionit 16
8. Imazhet dhe Videot e Gjeneruara nga Inteligjenca Artificiale 18
9. Aktivizmi Mediatik i të Rinjve 20
10. Çfarë është Mendimi Kritik? 22
11. Aftësitë dhe Mjetet e Mendimit Kritik 24
12. Gabimet Logjike 26
13. Leximi Kritik i Mesazheve Mediatike 28
14. Analiza e Artikujve të Lajmeve 30
15. Perspektiva Globale mbi Lajmet 32

Mësimi 1

Hyrje në Njohuritë për Lajmet

Koha për përgatitje: ***30 minuta*** *Kohëzgjatja e modulit: 1 x 60 minuta*

Abstrakt

Ky modul u prezanton pjesëmarrësve konceptin e njohurive për lajmet, duke u përqendruar në përkufizimin, rëndësinë dhe zbatimet praktike të tyre në peizazhin mediatik të sotëm. Pjesëmarrësit do të eksplorojnë mënyrat se si të vlerësojnë në mënyrë kritike burimet e lajmeve, të identifikojnë paragjykimet dhe të dallojnë informacionin e besueshëm. Përmes diskutimeve, aktiviteteve dhe shembujve nga jeta reale, mësimi synon t'i pajisë pjesëmarrësit me mjete për të përballuar dezinformimin, për të kuptuar rolin e lajmeve në shoqëri dhe për t'u bërë konsumatorë të përgjegjshëm të medias.

Burime edukative online

- ***Mësimi mbi Njohuritë për Lajmet*** nga kursi online në Moodle "Sorting Facts from Fiction
- ***Kuizi*** mbi Njohuritë për Lajmet nga kursi online në Moodle "Sorting Facts from Fiction"
- ***Mjete për verifikimin e fakteve*** si Google Fact Check Explorer, YouTube DataViewer dhe Google Lens

Fjalë kyçe:

Njohuri për Lajmet
Burime të Besueshme
Verifikimi i Fakteve
Keqinformim

Qëllimi i modulit:

Qëllimi i këtij moduli është të njohë të rinjtë me rëndësinë e njohurive për lajmet në epokën dixhitale. Moduli thekson aftësinë për të analizuar në mënyrë kritike burimet e lajmeve dhe për të verifikuar saktësinë e informacionit. Synimi është fuqizimi i pjesëmarrësve për të marrë vendime të informuara dhe për të kontribuar në një shoqëri më të vetëdijshme, duke ulur përhapjen e keqinformimit.

Rezultati i modulit:

Objektivi i këtij moduli është të njohë të rinjtë me rëndësinë e njohurive për lajmet në epokën digjitale. Ai vë në dukje aftësinë për të analizuar në mënyrë kritike burimet e lajmeve dhe për të verifikuar saktësinë e informacionit. Synimi është të fuqizohen pjesëmarrësit që të marrin vendime të informuara dhe të kontribuojnë në një shoqëri më të vetëdijshme, duke reduktuar përhapjen e keqinformimit.

Procesi i zbatimit të modulit

Min. 1–5: Hyrje

- Filloni me një pyetje nxitëse: "Çfarë do të thotë për ju njohuria për lajmet?"
- Jepni një përmbledhje të shkurtër të modulit dhe rëndësinë e tij në botën e sotme të dominuar nga media.
- Jepni një shembull të keqinformimit dhe ndikimin e tij, si për shembull një lajm i rremë që është bërë viral.

Min. 6–20: Aktivitet ndërveprues

- Diskutoni përkufizimin dhe fushëveprimin e njohurive për lajmet, duke theksuar dallimet midis lajmeve faktike (hard news), editorialeve, artikujve të opinionit dhe përmbajtjes së sponsorizuar.
- Eksploroni rolin e lajmeve në shoqëri, duke nënvizuar funksionin e tyre në informimin e qytetarëve, mbajtjen përgjegjëse të institucioneve dhe nxitjen e kohezionit shoqëror.
- Drejto një diskutim në grup mbi sfidat e keqinformimit në epokën digjitale.

Min. 21–50: Zbatim Praktik

- Udhëzoni pjesëmarrësit në një ushtrim për verifikimin e fakteve duke përdorur shembuj nga jeta reale.
- Drejtoni një aktivitet në grup ku pjesëmarrësit analizojnë një histori lajmi për besueshmërinë e saj duke shqyrtuar burimin, provat dhe paragjykimet e mundshme.
- Prezantojuni mjete për verifikimin e fakteve dhe demonstroni mënyrën e përdorimit të tyre në mënyrë efektive.
- Inkurajoni pjesëmarrësit të vlerësojnë disa burime lajmesh për të krahasuar dhe kontrolluar informacionin.

Min. 51–60: Përfundimi

Përmblidhni pikat kyçe të diskutuara në modul, duke theksuar rëndësinë e vlerësimit kritik dhe konsumit të përgjegjshëm të medias.
Shtroni pyetje reflektuese si:

- “Si mund t’i zbatosh aftësitë për njohuritë mbi lajmet në jetën tënde të përditshme?”
- “Çfarë hapash mund të ndërmarrësh për të luftuar keqinformimin në komunitetin tënd?”
  Ofroni burime për të mësuar më tej, duke përfshirë mjete online dhe artikuj mbi njohuritë për lajmet.

Materiale/Mjete

Projektor video; laptop/kompjuter desktop; lidhje interneti; qasje në Moodle; shembuj artikujsh lajmesh dhe skenarë për verifikimin e fakteve; fletë shpërndarëse ose lidhje digjitale për mjetet e verifikimit të fakteve; prezantim në PowerPoint/Prezi i pasuruar me materiale vizuale (imazhe dhe klipe video).

Mësimi 2:

Llojet e Medias – Tradicionalja vs Digjitalja, Masive & Sociale

Koha për përgatitje: ***30 minuta*** *Kohëzgjatja e modulit: 1 x 60 minuta*

Abstrakt

Ky modul shqyrton evolucionin e medias nga platformat tradicionale te ato digjitale, duke analizuar veçoritë, rolet dhe ndikimin e tyre në komunikimin modern. Pjesëmarrësit do të fitojnë njohuri mbi karakteristikat dalluese të medias tradicionale, përfshirë formatin e shtypur, transmetimet dhe formatet e jashtme (si posterët), si dhe mbi ngritjen e platformave të medias digjitale si faqet e internetit, blogjet, rrjetet sociale dhe shërbimet e transmetimit të videove.
Moduli thekson dallimet midis komunikimit njëdrejtimësh në median tradicionale dhe natyrës ndërvepruese të platformave digjitale, duke vënë në pah përfshirjen e audiencës, aksesin, personalizimin e përmbajtjes dhe besueshmërinë. Pjesëmarrësit do të kuptojnë gjithashtu sfidat që paraqet keqinformimi në hapësirat digjitale dhe rëndësinë e verifikimit të fakteve dhe vlerësimit kritik të burimeve të informacionit.

Burime edukative online

- ***Moduli*** *mbi Mediat Tradicionale kundrejt Medias Digjitale, Masive dhe Sociale nga kursi online në Moodle "Sorting Facts from Fiction"*
- ***Kuici*** *mbi Mediat Tradicionale kundrejt Medias Digjitale, Masive dhe Sociale nga kursi online në Moodle "Sorting Facts from Fiction"*

Fjalë kyçe

Evolucioni i Medias,
Media Tradicionale,
Media Digjitale,
Media Sociale,
Ndërveprueshmëria

Qëllimi i modulit

Qëllimi i këtij moduli është të zhvillojë kuptimin e pjesëmarrësve mbi evolucionin e medias, me fokus te dallimet dhe ndërlidhja mes platformave tradicionale dhe atyre digjitale. Ai synon të përmirësojë njohuritë për median duke nxitur mendimin kritik mbi besueshmërinë, aksesueshmërinë dhe ndërveprimin e llojeve të ndryshme të medias. Moduli gjithashtu synon të pajisë pjesëmarrësit me aftësi praktike për vlerësimin e burimeve të informacionit dhe për të promovuar konsum të përgjegjshëm mediatik.

Rezultati i modulit

Qëllimi i këtij moduli është të njohë të rinjtë me rëndësinë e njohurive për lajmet në epokën digjitale. Ai vë në pah aftësinë për të analizuar në mënyrë kritike burimet e lajmeve dhe për të verifikuar saktësinë e informacionit. Synimi është të fuqizohen pjesëmarrësit që të marrin vendime të informuara dhe të kontribuojnë në një shoqëri më të vetëdijshme, duke reduktuar përhapjen e keqinformimit.

Procesi i zbatimit të modulit

Min. 1–5: Hyrje

- Filloni me një pyetje : “Cilën platformë mediatike përdorni më shpesh dhe pse?”
- Përshkruani shkurtimisht qëllimin dhe rezultatet e pritshme të mësimit, duke theksuar rëndësinë e edukimit mediatik.

Min. 6–15: Prezantimi i përmbajtjes

- ***Media Tradicionale:*** *Shpjegoni karakteristikat e medias së shtypur, transmetimeve (radio/TV) dhe medias së jashtme (p.sh. postera), duke u fokusuar te besueshmëria dhe natyra njëdrejtimëshe e komunikimit.*
- ***Media Digjitale:*** *Diskutoni rreth faqeve të internetit, blogjeve, rrjeteve sociale dhe shërbimeve të transmetimit (streaming), duke theksuar ndërveprueshmërinë dhe personalizimin e përmbajtjes.*
- ***Krahasim:*** *Përdorni një diagram Venn të thjeshtë ose një tabelë për të përmbledhur dallimet dhe ngjashmëritë.*

Min. 16–30: Aktivitet ndërveprues

- Ndani pjesëmarrësit në çifte ose grupe të vogla.
- **Detyrë:** Analizoni pikat e forta dhe të dobëta të një shembulli të dhënë medieje (p.sh. një artikull në gazetë krahasuar me një postim në rrjete sociale).
- Grupet prezantojnë shkurtimisht përfundimet e tyre.

Min. 31–50: Diskutim dhe Zbatim Praktik

- ***Diskutim:*** *Drejtoni një diskutim mbi besueshmërinë e medias dhe keqinformimin. Shtroni pyetje si: “Pse mendoni se keqinformimi përhapet më shpejt në platformat digjitale?”*
- ***Detyrë praktike:*** *Ofroni shembuj të përzier të artikujve të lajmeve të vërteta dhe të rreme. Në çifte, pjesëmarrësit identifikojnë informacionin e besueshëm duke përdorur teknika të verifikimit të fakteve.*

Min. 51–60: Përfundime dhe Reflektime

- Përmblidhni pikat kryesore.
- Reflektoni mbi rëndësinë e edukimit mediatik.
- Caktoni një detyrë për në vazhdim: “*Analizo zakonet e tua të konsumimit të medias gjatë javës që vjen dhe identifiko një ndryshim që mund të bësh për t’i përmirësuar.”*

Materiale/ Mjete

Projektor video; laptop/kompjuter desktop; lidhje interneti; qasje në Moodle; shembuj artikujsh lajmesh dhe skenarë për verifikimin e fakteve; fletë shpërndarëse ose lidhje digjitale për mjetet e verifikimit të fakteve; prezantim në PowerPoint ose Prezi i pasuruar me materiale vizuale (imazhe dhe klipe video).

Mësimi 3

Roli i Algoritmeve dhe Mediave Sociale

Koha për përgatitje: ***30 minuta*** *Kohëzgjatja e modulit: : 1 x 60 minuta*

Abstrakt

Ky modul shqyrton rolin e algoritmeve të mediave sociale në formësimin e përmbajtjes që përdoruesit hasin në platformat digjitale. Algoritmet ndikojnë në shpërndarjen e gjithë informacionit online, përfshirë diskursin politik, dhe mund të kontribuojnë në përhapjen e keqinformimit. Pjesëmarrësit do të analizojnë se si këto algoritme krijojnë "flluska informacioni", përforcojnë paragjykimet dhe ndikojnë në opinionin publik. Gjithashtu, moduli do të prezantojë strategji praktike për të njohur manipulimin algoritmik dhe për të larmishuar burimet e lajmeve, me qëllim përmirësimin e edukimit mediatik dhe mendimit kritik.

Burime edukative online

- Studime mbi ndikimin e algoritmeve në rrjetet sociale
- Mjete online për verifikimin e lajmeve
- Raste studimore mbi keqinformimin (zgjedhjet, COVID-19)

Fjalë kyçe

Algoritme, flluska informacioni, rrjete sociale, keqinformim, edukim mediatik, mendim kritik

Qëllimi i modulit

Qëllimi i këtij moduli është t'u ndihmojë pjesëmarrësve të zhvillojnë një kuptim kritik mbi mënyrën se si algoritmet e rrjeteve sociale formësojnë përmbajtjen që ata shohin dhe ndikojnë në perceptimin e tyre ndaj informacionit. Përmes këtij moduli, pjesëmarrësit do të mësojnë të identifikojnë paragjykimet në përmbajtjen që u shfaqet dhe të zhvillojnë strategji për të larmishuar burimet e informacionit që konsumojnë.

Rezultati i modulit

Në përfundim të këtij moduli, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Shpjegojnë se si funksionojnë algoritmet dhe rolin e tyre në formësimin e përmbajtjes në rrjetet sociale
- Analizojnë ndikimin e algoritmeve në diskursin politik dhe mënyrën se si ato ndikojnë në përhapjen e keqinformimit
- Njohin flluskat e informacionit dhe paragjykimet algoritmike

Procesi i zbatimit të modulit

Min. 1–5: Hyrje

- Filloni me një sondazh ndërveprues: "Si i zgjidhni lajmet që lexoni?" ose "A mendoni se rrjetet sociale ndikojnë në mënyrën se si e shihni një temë të caktuar?"
- Diskutim: Shfaqni pjesëmarrësve dy rrjete sociale të ndryshme (një me përmbajtje konservatore dhe një me përmbajtje liberale) dhe kërkoni nga ata të hamendësojnë se si algoritmet mund të ndikojnë në atë që përdoruesit shohin ose cilët përdorues do t'i shohin ato përmbajtje.

Min. 6–20: Aktivitet ndërveprues

Tema diskutimi:

- Çfarë ndikimi kanë algoritmet në filtrat dhe përmbajtjen e rekomanduar në platforma si TikTok, Facebook, Twitter/X?
- Si ndikoi Twitter në zgjedhjet në SHBA dhe si ndikoi promovimi algoritmik i përmbajtjes në sjelljen e votuesve? Kërkimet tregojnë se mbi 50% e përdoruesve të Facebook-ut shohin vetëm përmbajtje që përputhet me bindjet e tyre, ndërsa vetëm 14,7% shohin rregullisht pikëpamje të kundërta.
- Aktivitet në grup: Ndani pjesëmarrësit në grupe të vogla dhe caktojuni secilit grup një skenar të ndryshëm algoritmik. Grupet analizojnë se si secili skenar do të ndikojë te përdoruesit dhe prezantojnë përfundimet e tyre.

Min. 21–50: Zbatim Praktik

- **Ushtrim:** Pjesëmarrësit do të hapin rrjetet e tyre sociale dhe do të shënojnë se cilat tema u shfaqen më shpesh. Diskutohet ndryshimi mes rrjeteve të pjesëmarrësve dhe si personalizimi ndikon në larmishmërinë e përmbajtjes.
- **Debat mbi ndikimin e algoritmeve:** "A duhet të rregullohen platformat e rrjeteve sociale për të parandaluar manipulimin?" "A ndihmojnë apo dëmtojnë algoritmet demokracinë?"
- **Ushtrim për verifikimin e fakteve:** Prezantoni pjesëmarrësit me mjete online për verifikimin e besueshmërisë së lajmeve. Pjesëmarrësit analizojnë artikuj të vërtetë dhe të rremë dhe përcaktojnë besueshmërinë e tyre.

Min. 51–60: Përfundimi

- Rikapitullim i pikave kryesore
- Diskutim reflektues: "Si mund t'ju ndihmojnë këto aftësi të orientoheni më mirë me informacionin online?"

Materiale / Mjete

Projektor video, laptop, lidhje interneti, pamje të ekraneve (screenshot) nga rrjete të ndryshme sociale, shembuj rastesh studimore, prezantim në PowerPoint ose Prezi, Canva.

Mësimi 4:

Epoka Post-së Vërtetës dhe Çrregullimi i Informacionit

Koha për përgatitje: ***30 minuta*** *Kohëzgjatja e modulit: 1 x 60 minuta*

Abstrakt

Ky modul shqyrton sfidat që sjell çrregullimi i informacionit në epokën digjitale. Ai analizon mënyrën se si përhapet informacioni i rremë dhe mashtrues dhe eksploron kategori të ndryshme të këtij fenomeni. Gjithashtu trajtohet koncepti i epokës post-së vërtetës. Pjesëmarrësit do të hetojnë shembuj nga jeta reale, do të njohin mjete të ndryshme për verifikimin e këtij informacioni dhe do të diskutojnë pasojat etike dhe shoqërore të keqinformimit. Qëllimi i këtij moduli është të forcojë aftësitë e mendimit kritik dhe edukimit mediatik, për të ndihmuar pjesëmarrësit të orientohen në një botë të mbushur me çrregullim informacioni.

Burime edukative online

- Artikujt e Institutit Poynter mbi verifikimin e fakteve në internet
- Mjetet e Universitetit Shtetëror të Arizonës për të identifikuar imazhe dhe video të rreme
- Zbulimi i lajmeve të rreme nga FactCheck.org në Facebook dhe platforma të tjera
- "Orientimi në një botë post-së vërtetës", fjalim TEDx nga Charles Sykes
- Mjete online për verifikim: Snopes, FactCheck.org, Politifact, guides.vote

Fjalë kyçe

Keqinformim,
Dezinformim,
Keqdashje me informacion (Malinformim),
Epoka post-së vërtetës,
Edukimi mediatik,
Mendim kritik

Qëllimi i modulit

Qëllimi i këtij moduli është te ndihmojë pjesëmarrësit të zhvillojnë një kuptim të fortë mbi mënyrën se si funksionon çrregullimi i informacionit dhe si ndikon ai në perceptimin publik. Gjatë këtij sesioni, pjesëmarrësit do të mësojnë si përhapet keqinformimi, si të identifikojnë format e ndryshme të përmbajtjes mashtruese dhe çfarë strategjish mund të përdoren për të verifikuar saktësinë e informacionit. Nëpërmjet një qasjeje të bazuar në mendimin kritik, ky modul synon t'i përgatisë pjesëmarrësit të angazhohen me median në mënyrë të përgjegjshme dhe të menduar.

Rezultati i modulit

Pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Dallojnë keqinformimin, dezinformimin dhe malinformimin(Informacion i keqpërdorur) .
- Identifikojnë teknikat e përdorura në përmbajtje mashtruese, si media të manipuluara apo të fabrikuara.
- Njohin shembuj konkretë të keqinformimit dhe analizojnë ndikimin e tyre.
- Përdorin mjete digjitale për të verifikuar informacionin dhe për të kundërshtuar narrativat e rreme.
- Marrin pjesë në diskutime rreth pasojave etike të çrregullimit të informacionit sot.

Procesi i zbatimit të modulit

Min. 1–10: Hyrje

- Angazhoni pjesëmarrësit me një sondazh : “A jeni përfshirë ndonjëherë me informacion online që më vonë rezultoi i pavërtetë? Kjo përfshin ndarjen, besimin apo përhapjen e atij informacioni.”
- Diskutoni përvojat personale me keqinformimin dhe prezantoni konceptet kryesore të mësimit.
- Shfaqni një video të shkurtër dhe nxitëse për të menduar rreth keqinformimit viral (opsionale, në varësi të kohëzgjatjes së diskutimit).

Min. 11–30: Aktivitet Ndërveprues

- Shpjegoni tre kategoritë kryesore të çrregullimit të informacionit: dezinformimi, keqinformimi dhe malinformimi.
- Jepni shembuj nga jeta reale, si keqinformimi gjatë zgjedhjeve, videot e manipuluara (deepfakes) dhe teoritë konspirative.
- Diskutoni se si emocionet dhe paragjykimet kontribuojnë në politikën post-së vërtetës.
- Ndani pjesëmarrësit në grupe të vogla për të analizuar raste studimore të ndryshme të keqinformimit.

Min. 31–50: Zbatim Praktik

- Drejtoni pjesëmarrësit për mënyrën se si të verifikojnë informacionin duke përdorur mjete për verifikimin e fakteve.
- Krahasoni përmbajtje të medias reale dhe të rreme, duke kërkuar për mospërputhje në kontekst dhe manipulim të imazheve.
- Drejtoni një debat mbi dilemat etike: “A duhet që platformat e rrjeteve sociale të rregullojnë më rreptësisht keqinformimin?”

Min. 51–60: Përfundimi

- Rikapitulloni mësimet e nxjerra, përfshirë rëndësinë e edukimit mediatik.
- Organizoni një kuiz në Kahoot për të përforcuar konceptet kryesore të çrregullimit të informacionit.
- Inkurajoni pjesëmarrësit të ushtrojnë teknikat e verifikimit të medias edhe jashtë klasës.

Materiale / Mjete

Projektor, laptop/kompjuter desktop, lidhje interneti; shembuj të përmbajtjes së manipuluar dhe të fabrikuar; qasje në mjete për verifikimin e informacionit (Snopes, TinEye, FactCheck.org); Kahoot ose një kuiz i ngjashëm.

Mësimi 5

Strategji Efektive të Kërkimit

Koha për përgatitje: 30 minuta *Kohëzgjatja e modulit: : 1 x 60 minuta*

Abstrakt

Ky modul shqyrton mënyrën se si të navigojmë në botën e gjerë të informacionit online duke përdorur strategji efektive kërkimi. Pjesëmarrësit do të mësojnë të përdorin fjalë kyçe dhe operatorë, mjete të avancuara kërkimi, dhe teknika të krahasimit të burimeve për të gjetur informacion të saktë dhe relevant në mënyrë efikase. Sesioni thekson rëndësinë e verifikimit të burimeve, kuptimit të paragjykimeve dhe përdorimit të mjeteve të sakta për ta kthyer procesin e kërkimit në një aftësi të vlefshme për kontekste personale dhe profesionale.

Burime edukative online

- Mësimi mbi Strategjitë Efektive të Kërkimit nga kursi online në Moodle "Sorting Facts from Fiction"
- Kuizi mbi Strategjitë Efektive të Kërkimit nga kursi online në Moodle "Sorting Facts from Fiction"
- Biblioteka e Burimeve për Strategjitë e Kërkimit

Fjalë kyçe

Strategjitë e Kërkimit, Fjalët Kyçe, Operatorët e Kërkimit, Mjetet e Avancuara, Krahasimi i Burimeve, Besueshmëria e Informacionit

Qëllimi i modulit

Qëllimi i këtij moduli është të përmirësojë aftësinë e pjesëmarrësve për të kërkuar informacion në internet në mënyrë efektive, duke i mësuar strategjitë për përmirësimin e kërkimeve, verifikimin e besueshmërisë dhe identifikimin e paragjykimeve. Duke zotëruar këto aftësi, pjesëmarrësit do të jenë më të përgatitur për të gjetur informacion të besueshëm, për të kursyer kohë dhe për të shmangur keqinformimin.

Rezultati i modulit

- Kuptoni rëndësinë e strategjive efektive të kërkimit për të naviguar në informacionin online.
- Mësoni të përdorni fjalë kyçe dhe operatorë kërkimi për të përmirësuar rezultatet e kërkimit.
- Aplikoni mjete të avancuara kërkimi për kërkime të sakta dhe të synuara.
- Zhvilloni teknika krahasimi për të verifikuar besueshmërinë e burimeve.
- Njihni rolin e informacionit të besueshëm në marrjen e vendimeve të informuara.

Procesi i zbatimit të modulit

min. 1 - 10 : Hyrje

- Filloni me një pyetje nxitëse: “Çfarë sfidash hasni kur kërkoni informacion online?”
- Jepni një përmbledhje të modulit, duke theksuar vlerën e kërkimeve efikase dhe të sakta.
- Ndani një shembull të një sfide të zakonshme në kërkim, si për shembull gjetja e burimeve të besueshme për një temë aktuale dhe trendi.

min. 11 - 30: Aktivitet ndërveprues

- Diskutoni rolin e fjalëve kyçe dhe operatorëve të kërkimit në përmirësimin e rezultateve të kërkimit. Prezantoni operatorë të tillë si thonjëza (" "), shenja minus (-), OR dhe karakteri përfaqësues (*).
- Jepni shembuj se si kërkimet specifike mund të japin rezultate më të sakta.
- Eksploroni përfitimet e mjeteve të avancuara të kërkimit, si filtrat për datën, gjuhën dhe llojin e skedarit.
- Drejtoni një diskutim në grup mbi gabimet e zakonshme në kërkimet online dhe mënyrat për t'i kapërcyer ato.

min. 30 - 50: Zbatim Praktik

- Organizoni një aktivitet praktik ku pjesëmarrësit ushtrohen në përdorimin e operatorëve të kërkimit dhe mjeteve të avancuara për të gjetur informacion specifik.
- Udhëzoni pjesëmarrësit të analizojnë një kërkim për të verifikuar besueshmërinë dhe neutralitetin e informacionit. Prezantoni teknikat e krahasimit duke u bazuar në informacion nga disa burime të njohura dhe të besueshme.
- Inkurajoni pjesëmarrësit të ndajnë përvojat e tyre dhe të diskutojnë strategjitë për përmirësimin e zakonit të tyre të kërkimit.

min. 51 - 60: Përfundime

- Përmbledhni strategjitë kryesore të diskutuar, duke theksuar rëndësinë e saktësisë dhe besueshmërisë në kërkimet online.
- Shtroni pyetje reflektuese si: "Si mund t'ju përmirësojnë këto strategji procesin e kërkimit?"
- "Çfarë hapash do të ndërmerrni për t'u siguruar që informacioni që gjeni është i saktë?"
- Ofroni burime për praktikim të mëtejshëm, duke përfshirë mjete dhe udhëzues mbi teknikat e avancuara të kërkimit.

Materiale / Mjete

Projektor video; laptop/kompjuter desktop; lidhje interneti; qasje në Moodle; shembuj faqesh interneti të dobishme për kërkime efektive; fletë pune ose lidhje digjitale për mjete të avancuara kërkimi; prezantim në PowerPoint ose Prezi.

Mësimi 6

Lajmet e Rreme, Dezinformimi dhe Keqinformimi

Koha për përgatitje: 30 minuta *Kohëzgjatja e modulit: 1 x 60 minuta*

Abstrakt

Ky modul trajton përhapjen e "lajmeve të rreme" në botën digjitale të sotme dhe sqaron dallimin midis keqinformimit (informacionit të pavullnetshëm të pasaktë) dhe dezinformimit (përmbajtjes së qëllimshme të rreme). Duke shqyrtuar shembuj nga jeta reale, pjesëmarrësit mësojnë të identifikojnë tiparet e medias mashtruese dhe ushtrohen në përdorimin e mjeteve për të verifikuar ose hedhur poshtë pretendimet e dyshimta. Moduli thekson rëndësinë e qëndrimit të informuar dhe angazhimit kritik në internet.

Burime edukative online

- *Mësimi mbi Lajmet e Rreme në kursin online në Moodle*
- *Kuizi mbi Lajmet e Rreme në kursin online në Moodle*
- *Faqet për verifikimin e fakteve (p.sh., Faktograf, Raskrikavanje)*
- *Mjetet për kërkim të imazheve në mënyrë të kundërt (Google Reverse Image Search, TinEye)*

Fjalë kyçe

Lajme të rreme, Dezinformim, Keqinformim, Verifikim i fakteve, Edukimi mediatik, Mendim kritik

Qëllimi i modulit

- Të përcaktojë "lajmet e rreme," dezinformimin dhe keqinformimin, dhe të sqarohet si ndryshojnë ndërmjet tyre.
- Të ndihmojë pjesëmarrësit të zhvillojnë aftësi praktike për të zbuluar dhe hedhur poshtë informacionin mashtrues ose të rremë.
- Të theksojë pasojat reale në botën e vërtetë nga përhapja e pretendimeve të pabazuara.

Rezultati i modulit

Në përfundim të këtij moduli, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Identifikojnë dallimet kryesore midis keqinformimit dhe dezinformimit.
- Vërejnë shenjat e zakonshme paralajmëruese të lajmeve të rreme.
- Përdorin mjete bazë për verifikim për të vlerësuar besueshmërinë e artikujve të lajmeve.
- Reflektojnë mbi pasojat etike të ndarjes së informacionit të pabazuar.

Procesi i zbatimit të modulit

min. 1 - 5 : Hyrje

- Aktivitet: Kërkoni nga pjesëmarrësit të kujtojnë një lajm "shqetësues" ose "të pabesueshëm" që kanë hasur së fundmi në rrjetet sociale. A e kanë verifikuar atë para se ta besonin ose ta ndanin?
- Diskutim: Eksploroni shkurtimisht se sa lehtë është të hasësh histori surprizuese online, por jo gjithmonë të konfirmosh autenticitetin e tyre.

min. 6 - 20: Aktivitet ndërveprues

- Prezantim ku prezantohen përkufizimet kyçe si Lajmet e Rreme, Dezinformimi, Keqinformimi.
- Diskutim në grup ku eksplorohen arsyet pas krijimit ose përhapjes së lajmeve të rreme (përfitime financiare, agjenda politike, ose gabime të thjeshta) dhe mënyrat për t'i hedhur poshtë ato.
- Shfaqje e shembujve të shkurtër rajonalë të dezinformimit dhe keqinformimit.

min. 21 - 50: Zbatim Praktik

- Aktivitet: "Real apo i Rremë?"
- Jepni grupeve të vogla mostra artikujsh lajmesh (disa të vërteta, disa të rreme).
- Pjesëmarrësit analizojnë secilën mostër duke përdorur pyetje udhëzuese: A është burimi i besueshëm? A ka shenja të dukshme paralajmëruese në tituj ose imazhe? Ata duhet të etiketojnë secilin artikull si i mundshëm i vërtetë, i mundshëm i rremë, ose i pasigurt.
- **Demonstrim Mjeti:** Tregoni si të përdoret kërkimi i imazhit në mënyrë të kundërt me Google Reverse Image Search ose TinEye.
- Përdorni një faqe verifikimi fakte si Faktograf për të parë si verifikohen zakonisht pretendimet.
- **Përmbledhje:** Diskutoni përfundimet e çdo grupi, duke nxjerrë në pah histori të rreme veçanërisht të zgjuara ose të holla në manipulim.

min. 51 - 60: Përfundime

- Përmbledhni pikat thelbësore si Dezinformimi kundrejt keqinformimit, shenjat për t'u vënë re (tituj të ekzagjeruar, burime të dyshimta) dhe mjetet praktike (faqet për verifikimin e fakteve, kontrollimi i besueshmërisë së burimeve).
- Pyetje reflektuese:
- "Si mund të ulë përhapjen e lajmeve të rreme verifikimi i informacionit para se ta ndani atë?"
- "Pse mund të krijojë dikush qëllimisht dezinformim?"
- Më tepër: Inkurajoni pjesëmarrësit të ushtrojnë verifikimin e një lajmi të njohur para se të fillojë sesioni tjetër, duke përdorur mjetet e demonstruara.

Materiale / Mjete

Projektor ose ekran për të shfaqur shembuj titujsh dhe imazhesh; pajisje me lidhje interneti (laptopë, tableta ose telefona inteligjentë) për verifikimin e fakteve dhe kërkim të imazheve në mënyrë të kundërt; qasje në faqet e verifikimit të fakteve (Faktograf, Raskrikavanje).

Mësimi 7

Verifikimi i Fakteve dhe Mjetet e Kontrollit të Informacionit

Koha për përgatitje: 30 minuta *Kohëzgjatja e modulit: 1 x 60 minuta*

Abstrakt

Në epokën digjitale të sotme, keqinformimi dhe dezinformimi përhapen shpejt. Është thelbësore të kesh aftësinë për të analizuar dhe verifikuar informacionin në mënyrë kritike, veçanërisht për gazetarët, edukatorët dhe përdoruesit e përditshëm të medias. Ky modul do të fokusohet në mjetet dhe teknikat për verifikim efektiv të fakteve, si dhe në gabimet e zakonshme që duhet shmangur. Pjesëmarrësit do të fitojnë përvojë praktike duke përdorur burime për të verifikuar pretendime, imazhe, video dhe burime, duke nxitur një konsum mediatik të informuar dhe të përgjegjshëm.

Burime edukative online

- ***Mësimi*** *mbi Verifikimin e Fakteve dhe Mjetet e Kontrollit nga kursi online në Moodle "Sorting Facts from Fiction"*
- ***Kuizi*** *mbi Verifikimin e Fakteve dhe Mjetet e Kontrollit nga kursi online në Moodle "Sorting Facts from Fiction"*

Fjalë kyçe

Verifikimi i fakteve,
Mjetet e verifikimit,
Edukimi mediatik,
Dezinformimi,
Keqinformimi

Qëllimi i modulit

Qëllimi i këtij moduli është të pajisë pjesëmarrësit me aftësitë dhe njohuritë për të përdorur mjetet e verifikimit të fakteve, të zbatojnë teknika kritike për të vlerësuar burimet dhe të identifikojnë gabimet e zakonshme gjatë procesit të verifikimit të informacionit.

Rezultati i modulit

Në përfundim të modulit, pjesëmarrësit do të zhvillojnë një kuptim kritik mbi rëndësinë e verifikimit të fakteve dhe rolin e tij në luftimin e keqinformimit. Ata do të njohin mjetet dhe teknikat kryesore të verifikimit të fakteve, që do t'i lehtësojnë të verifikojnë lajmet, imazhet, videot dhe forma të tjera të medias në mënyrë efektive. Gjithashtu, do të mësojnë të vlerësojnë besueshmërinë e burimeve, të njohin dhe shmangin gabimet e zakonshme si paragjykimi i konfirmimit dhe keqkuptimi i satirës, dhe të aplikojnë këto aftësi për t'u bërë konsumatorë më të ndërgjegjshëm të medias.

Procesi i zbatimit të modulit

min. 1 - 5: Hyrje

- **Diskutim:** Pyesni pjesëmarrësit për përvojat e tyre me keqinformimin dhe si verifikojnë informacionin kur hasin diçka të dyshimtë.
- **Prezanto temën:** Shpjegoni shkurtimisht rëndësinë e verifikimit të fakteve dhe rreziqet e keqinformimit dhe dezinformimit.
- **Përcaktoni termat kyç:** Prezantoni konceptet si verifikimi i fakteve, dezinformimi dhe keqinformimi.

min. 6 - 15: Procesverbal: Përmbledhje e Mjeteve të Verifikimit të Fakteve

- **Prezantojini një listë mjetesh:** Prezantoni mjete si Google Fact Check Explorer, Snopes, PolitiFact, FactCheck.org, TinEye dhe InVID. Jepni një përmbledhje të shkurtër për secilin mjet dhe demonstroni përdorimin e tyre me shembuj konkretë.
- **Diskutim në grup:** Kërkoni nga pjesëmarrësit të ndajnë cilat mjete i konsiderojnë më të dobishme dhe pse.

min. 16 - 30: Aktiviteti 2 – Teknikat për Verifikimin e Informacionit

- **Krahasimi i burimeve:** Tregoni se si të krahasohen pretendimet me burime të besueshme. Përdorni një shembull të një pretendimi shëndetësor ose një lajmi dhe demonstroni se si të konsultohen faqet e besueshme si WHO, PubMed.
- **Kërkimi i imazhit në mënyrë të kundërt dhe metadatat:** Tregoni pjesëmarrësve se si të përdorin Google Reverse Image Search dhe mjete të tjera si FotoForensics për të kontrolluar autenticitetin e imazheve.
- **Vlerësimi i paragjykimit të burimit:** Demonstroni shkurtimisht se si të kontrollohet paragjykimi i një burimi duke përdorur mjete si Media Bias/Fact Check.

min. 31 - 50: Aktiviteti 3: Identifikimi i Gabimeve të Zakonta

- **Prezantojini gabimet e zakonshme:** Diskutoni për paragjykimin e konfirmimit, mbështetjen e tepërt në një burim të vetëm, keqkuptimin e satirës dhe injorimin e kontekstit.
- **Diskutim ndërveprues:** Jepni shembuj për secilën gabim dhe pyetni pjesëmarrësit se si do të vepronin në secilin skenar.

min. 51 - 60: Procesverbal: Mbyllja dhe Pyetje & Përgjigje (Q&A)

- **Rikapitulloni pikat kryesore:** Përmbledhni mjetet, teknikat dhe gabimet që u diskutuan.
- **Sesioni i pyetjeve dhe përgjigjeve:** Jepni mundësi pjesëmarrësve të bëjnë pyetje ose të ndajnë mendimet e tyre mbi mësimin.

Materiale/ Mjete

Projektor video, kompjuter ose telefon inteligjent, lidhje interneti, Google Fact Check Explorer, Snopes, PolitiFact, FactCheck.org, TinEye, fletë pune për përmbledhje dhe shembuj, prezantim në Prezi ose PowerPoint.

Mësimi 8

Imazhet dhe Videot e Gjeneruara nga Inteligjenca Artificiale

Koha për përgatitje: 30 minuta *Kohëzgjatja e modulit: 1 x 60 minuta*

Abstrakt

Ky modul shqyrton përhapjen në rritje të imazheve dhe videove artificiale, duke u fokusuar në mënyrën se si krijohen, ndikimin që kanë në shoqërinë tonë dhe strategjitë për zbulimin e përmbajtjes së gjeneruar nga inteligjenca artificiale. Pjesëmarrësit do të analizojnë raste të njohura të medias së krijuar nga IA, do të zbulojnë teknika për të hedhur poshtë këtë përmbajtje dhe do të diskutojnë implikimet etike dhe morale. Qëllimi i këtij moduli është të forcojë aftësitë e edukimit mediatik dhe mendimit kritik të pjesëmarrësve në epokën e IA-së.

Burime edukative online

- Mësimi mbi Imazhet dhe Videot e Gjeneruara nga AI nga kursi online në Moodle "Sorting Facts from Fiction"
- Kuizi që mbulon aspekte të ndryshme të përmbajtjes së gjeneruar nga IA nga kursi online në Moodle "Sorting Facts from Fiction"
- Burime online për verifikim si: TinEye, Google Reverse Image Search, FotoForensics, InVID Verification Plugin, Sensity.

Fjalë kyçe

Media e Gjeneruar nga IA,
Deepfake,
Edukimi Mediatik,
Mendimi Kritik,
IA Etike

Qëllimi i modulit

Qëllimi i këtij moduli është t'u sigurojë pjesëmarrësve një mësim të plotë për kuptimin e imazheve dhe videove të gjeneruara nga inteligjenca artificiale, mënyrën se si krijohen dhe implikimet shoqërore që ato sjellin. Synimi është të përmirësojë aftësitë e mendimit kritik dhe edukimit mediatik të pjesëmarrësve duke i mësuar si të zbulojnë mediat e gjeneruara nga IA, të vlerësojnë autenticitetin e tyre duke përdorur mjete dhe metoda të ndryshme, dhe të mendojnë për pasojat etike të përdorimit të tyre. Kuptimi i teknologjisë së IA-së është thelbësor për të naviguar në një botë digjitale gjithnjë e më shumë të ndikuar prej saj, dhe ky modul ndihmon në mundësimin e ndërveprimeve të informuara dhe përgjegjëse me këtë lloj materiali mediatik.

Rezultati i modulit

Pjesëmarrësit do të mësojnë se si prodhohet dhe konsumohet media e gjeneruar nga IA, si dhe si të njohin dhe verifikojnë përmbajtjen artificiale përmes analizës kritike dhe mjeteve digjitale. Ata do të shqyrtojnë disa çështje etike si keqinformimi dhe privatësia lidhur me përdorimin e IA-së, do të aplikojnë aftësitë e reja të fituara për të vlerësuar autenticitetin dhe do të angazhohen në diskutime të informuara mbi ndikimet e medias së gjeneruar nga IA në shoqërinë e sotme.

Procesi i zbatimit të modulit

min. 1 - 5: Hyrje

- Angazhoni pjesëmarrësit dhe prezantoni temën duke bërë pyetje të përgjithshme lidhur me temën.
- Shembull: Një pyetësor në Mentimeter: "A keni hasur ndonjëherë në një imazh ose video të gjeneruar nga AI? Nëse po, ku?"
- Shfaqni shembuj të tillë të medias së gjeneruar (video deepfake, art i gjeneruar nga AI).

Prezantojini temën dhe përshkruani qëllimet e mësimit.

min. 6 - 20 : Aktivitet ndërveprues

- Shpjegoni Diskutimin: Rastet e njohura të medias së gjeneruar nga AI:
  -Video DeepFake të Tom Cruise në TikTok
  -Vepra arti të gjeneruara nga AI që fitojnë konkurse
